



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim A-B, B-A (1)

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof.Asoc.Dr. Alma Pinari

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 60 seminare

Viti akademik: 2024-2025, Viti III, semestri 2

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: alma.pinari@unitir.edu.al
almapinari@gmail.com

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit është i mundur: Përcaktimi i strategjisë së përkthimit. Njohja e studentit me nocionet bazë të përkthimit dhe me ligjësitë e procesit përkthimor. Përcaktimi i strukturës përmbajtësore të origjinalit dhe segmentimi i tekstit në njësi përkthimore. Analiza e strukturave sintaksore të ndërlikuara. Përzgjedhja e barasvlerësit përkthimor në varësi nga veçoritë e sistemit dhe normave gjuhësore të rusishtes dhe shqipes.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojë shprehjet praktike, kryesisht në përkthimet nga gjuha ruse në gjuhën shqipe.
2. Të zhvillojë të kuptuarit e fjalës në vartësi nga konteksti i përdorimit të saj.
3. Të përdorë transformimet në përkthim dhe të përcaktojë masën optimale të përdorimit të tyre.
4. Të përcaktojë përkthimet dhe dallimet mes gjuhëve gjatë ballafaqimit të të dy sistemeve gjuhësore.

Rezultatet e pritshme:

1. Zhvillimi i aftësive përkthimore praktike – Studenti do të jetë në gjendje të përkthejë në mënyrë korrekte tekste nga gjuha ruse në shqipe, duke identifikuar njësitet përkthimore dhe duke aplikuar strategjitë përkatëse në përputhje me strukturën dhe përmbajtjen e origjinalit.
2. Analiza dhe zbatimi i veçorive gjuhësore – Studenti do të kuptojë përdorimin e fjalës në kontekst dhe do të analizojë struktura sintaksore të ndërlikuara, duke përcaktuar barasvlerësit përkthimorë sipas normave të të dyja gjuhëve.
3. Zbatimi i transformimeve përkthimore – Studenti do të përdorë transformime gjuhësore në përkthim në mënyrë të arsyetuar dhe efektive, si dhe do të identifikojë ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet rusishtes dhe shqipes në nivel strukture dhe kuptimi.